

LIGJ
Nr. 177/2013

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 8438, DATË 28.12.1998, “PËR TATIMIN MBI TË ARDHURAT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, 84, pika 4, dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

Neni 1

Në nenin 8, shkronja “gj” shfuqizohet.

Neni 2

Në nenin 8/1, në fjalinë e parë, fjala “vetjakë” zëvendësohet me fjalën “personale”.

Neni 3

Në nenin 8/1, “Të ardhura të përjashtuara”, fjalia e parë e pikës 11 ndryshohet si më poshtë:

“Kalimi i së drejtës së pronësisë mbi tokën bujqësore nga një fermer i regjistruar te një fermer apo person fizik a juridik që kryen aktivitet bujqësor është i përjashtuar nga tatimi mbi të ardhurat personale.”.

Neni 4

Pasqyra nr. 1, e përmendur në pikën 1 të nenit 9, “Tarifat tatimore”, që i bashkëlidhet ligjit, zëvendësohet me pasqyrën me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 5

Nenet 12, 12/1, 12/2, 12/3, 12/4, 12/5 dhe 12/6 shfuqizohen.

Neni 6

Neni 13/4 “Shkalla tatimore” shfuqizohet.”

Neni 7

Në nenin 16, “Fusha e veprimit të tatimit mbi fitimin”, dhe kudo në përmbajtje fjalët “i tatimit mbi të ardhurat personale mbi biznesin e vogël” zëvendësohen me fjalët “i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin mbi biznesin e vogël”.

Neni 8

Në nenin 25, “Rezervat speciale për bankat dhe shoqëritë e sigurimit”, fjalët “por, në çdo rast, pa tejkaluar masën e përcaktuar në rregullat e Bankës së Shqipërisë për këtë qëllim” shfuqizohen.

Neni 9

Neni 28, “Shkalla tatimore”, ndryshohet si më poshtë:

“Neni 28

Shkalla tatimore

Tatimi mbi fitimin është 15 për qind.”.

Neni 10

Neni 35 “Mbajtja e tatimit dhe regjistrimi” riformulohet si më poshtë:

“Neni 35

Mbajtja e tatimit në burim, regjistrimi, deklarimi dhe pagesa

a) Paguesi i shumave është i detyruar të mbajë regjistrime për llogaritjen dhe mbajtjen e tatimit në burim për çdo përfitues të ardhurash dhe t’i vërë ato në dispozicion të organeve tatimore dhe të personit përfitues të të ardhurave, për të cilin është bërë pagesa.

b) Paguesi i shumave, për efekt të mbajtjes së tatimit në burim, të parashikuar në nenin 33, “Depozitimi i vendimit për miratimin e rezultatit vjetor dhe destinimi i fitimit”, është i detyruar të llogarisë, të mbajë, të deklarojë dhe të derdhë tatimin e mbajtur në burim, në llogaritë e organeve tatimore deri në datën 20 të muajit pasardhës të muajit të pagesës.

c) Ministri i Financave përcakton me udhëzim formën dhe përmbajtjen e deklaratës.

ç) Deklarata e tatimit të mbajtur në burim dorëzohet në një nga mënyrat e parashikuara në ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, në drejtorinë rajonale ku është i regjistruar paguesi i shumave.”.

Neni 11

Në nenin 38 “Dispozitat kalimtare”, pas pikës 7 shtohet pika 8 me këtë përmbajtje:

“8. Vetëm për periudhën tatimore të vitit 2013, subjektet e biznesit të vogël të tatimit mbi të ardhurat personale plotësojnë dhe dorëzojnë Deklaratën e Tatimit mbi të Ardhurat Personale të Biznesit të Vogël, sipas shkronjës “gj” të nenit 8 dhe neneve nga 12 deri në nenin 12/6 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, brenda datës 10 shkurt 2014.”.

Neni 12

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë, botohet në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 janar 2014.

Miratuar në datën 28.12.2013

Dekretuar me dekretin nr. 8444, datë 30.12.2013 “Për shpallje ligji dhe dhënien e pëlqimit për hyrjen në fuqi menjëherë të ligjit” të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani.

Tabela nr. 1 Tabela për tatimin mbi të ardhurat personale nga punësimi

E ardhura e tatueshme (në lekë/muaj)		Përqindje
Nga	Deri në (përfshirë)	
0	30 000	zero për qind
30 001	130 000	+ 13 për qind të shumës mbi 30 000 lekë
130 001	Më tepër	13 000 lekë + 23 për qind të shumës mbi 130 000 lekë